

# STATUTI I SHOQERISE AKSIONARE

## SH.A "FRIGORIFERI NR.2"

### NENI 1

Sot ne date 26/12/2012 ( Njete gjashte dhjetor dymije e dymbedhete) ne qytetin e Korces duke u bazuar ne vullnetin e tij te lire, te plote dhe te singerte ne baze te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare " **neni 230 pika 2** aksionaret e shoqerise tregtare te mbledhur ne mbledhjen e asamblese te dites se sotme kane hartuar kete statut te pershtatur me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 lidhur me organizimin, administrimin dhe drejtimin e shoqerise tregtare **SH.A "Frigoriferi Nr.2"**

### NENI 2

#### FORMA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete formen e shoqerise aksionare me oferte private, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri aksionare me oferte publike.

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

### NENI 3

#### EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte: **SH.A "Frigoriferi Nr.2"**

Ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga shoqeria, emertimi i shoqerise do te paraprihet nga fjalet "Shoqeri Aksionare" ose iniciallet "Sh.a".

### NENI 4

#### SELIA

Shoqeria e ka seline ne Korce, ne Zona Industriale rruga Korce -Maliq Km1.

Pervec veprimtarise ne nivel lokal, shoqeria ka te drejten e krijimit dhe mbylljes se filjaleve, agjensive dhe zyrave te perfaqesimit brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Selia mund te trasferohet ne cdo vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise, me nje vendim te Keshillit Mbikqyres, me kusht qe ky vendim te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se pergjithshme.


### NENI 5

#### OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Grumbullim, tregetim, ruajte produktesh bujqesore, bektorale, perpunim kermilli e peshku etj.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.



Frigoriferi Nr. 2  
SH A  
Korce Albania

## NENI 6 KOHEZGJATJA


Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.  
Ne perputhje me kete Statut, shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj kur e sheh te arsyeshme,  
apo ne rastet e parashikuara nga Ligji.

## NENI 7 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 47.584.000 leke.  
Kapitali ndahet ne 47584 aksione me vlere nominale 1 000 leke per aksion, te shlyera ne masen  
100% nga aksionaret e saj. Ky kapital eshte i vlefshem per regjistrimin e shoqerise. Aksionet jane te  
pandashme.


Aksioneret kane perkatesisht ne pronesi te tyre:

1. Abedin Mersini	0,08 %	ose 38 aksione
2. Adrian Bardhi	0,191 %	ose 91 aksione
3. Adrian Palo	0,317 %	ose 151 aksione
4. Adrian Rapushi	0,08 %	ose 38 aksione
5. Aleksandra Ciko	0,206 %	ose 98 aksione
6. Ana Endriko	0,08 %	ose 38 aksione
7. Anesti Konomi	0,048 %	ose 23 aksione
8. Anesti Kosho	0,731 %	ose 348 aksione
9. Arben Dellinja	0,063 %	ose 30 aksione
10. Armant Bendo	0,063 %	ose 30 aksione
11. Artire Bregu	0,048 %	ose 23 aksione
12. Athina Teqo	0,032 %	ose 15 aksione
13. Bashkim Jahollari	0,048 %	ose 23 aksione
14. Bashkim Ravoniku	0,032 %	ose 15 aksione
15. Bujar Myrtezai	0,071 %	ose 34 aksione
16. Çlirimtar Kotherja	0,048 %	ose 23 aksione
17. Donika Prifti	0,088%	ose 42 aksione
18. Edmond Shkurti	0,071 %	ose 34 aksione
19. Eftim Trako	0,055 %	ose 26 aksione
20. Epaminonda Kajno	0,048 %	ose 23 aksione




2  
Frigoriferi # 2  
SH A  
Korçe Albania

21. Evas Ballauri	0,128 %	ose 61 aksione
22. Fatos Çausholli	0,637 %	ose 303 aksione
23. Ferzilet Spaho	1,232 %	ose 586 aksione
24. Fitnet Mixha	0,469 %	ose 223 aksione
25. Gaqi Shallo	0,048 %	ose 23 aksione
26. Gjergj Zguri	0,08 %	ose 38 aksione
27. Gjergji Karanxha	0,914%	ose 435 aksione
28. Gjergji Leka	0,088 %	ose 44 aksione
29. Gjergji Trebicka	0,08 %	ose 38 aksione
30. Ibrahim Sadikaj	0,12 %	ose 57 aksione
31. Ilir Mihallari	0,477 %	ose 227 aksione
32. Ilir Nikollari	0,095 %	ose 45 aksione
33. Ilo Kita	0,023 %	ose 11 aksione
34. Jorgji Minga	0,032 %	ose 15 aksione
35. Kosta Durdi	0,063 %	ose 30 aksione
36. Lefteri Ceri	0,023 %	ose 11 aksione
37. Ligor Qirici	0,017 %	ose 8 aksione
38. Lilo Kristo	0,048 %	ose 23 aksione
39. Llambi Kolenorka	0,063 %	ose 30 aksione
40. Llazar Dengo	0,071 %	ose 34 aksione
41. Llazi Miti	0,048 %	ose 23 aksione
42. Llazi Risto	0,095%	ose 45 aksione
43. Lorenc Glozheni	0,08 %	ose 38 aksione
44. Luçi Heqimi	0,111 %	ose 53 aksione
45. Lulezim Aliaj	0,317%	ose 151 aksione
46. Mahmud Haxhillari	0,063 %	ose 30 aksione
47. Maksim Bilali	0,048 %	ose 23 aksione
48. Mane Aliko	0,24 %	ose 114 aksione
49. Mihal Leshi	0,477 %	ose 227 aksione



50. Mihal Trajko	0,088 %	ose 42 aksione
51. Miltjadh Veveçka	0,174 %	ose 83 aksione
52. Natasha Orgocka	0,351 %	ose 167 aksione
53. Naziqe Rushiti	0,458 %	ose 218 aksione
54. Nikollaq Bino	0,04 %	ose 19 aksione
55. Nikollaq Shallo	0,055 %	ose 26 aksione
56. Pandi Balliu	0,08 %	ose 38 aksione
57. Parashqevi Zisi	0,111 %	ose 53 aksione
58. Pellumb Shyti	0,24 %	ose 114 aksione
59. Piro Stefani	0,08 %	ose 38 aksione
60. Reta Pano	0,16 %	ose 76 aksione
61. Rozalina Lako	0,055 %	ose 26 aksione
62. Shahin Mersini	0,12 %	ose 57 aksione
63. Silvana Xhemali	0,16 %	ose 76 aksione
64. Simo Niço	0,088 %	ose 42 aksione
65. Sotir Demiri	0,111 %	ose 53 aksione
66. Sotiraq Lubonja	0,103 %	ose 49 aksione
67. Spiro Bardhi	88.278 %	ose 42006 aksione
68. Stavraq Ktona	0,048 %	ose 23 aksione
69. Thoma Moni	0,111 %	ose 53 aksione
70. Thoma Pallonguri	0,032 %	ose 15 aksione
71. Vangjel Karafili	0,063 %	ose 30 aksione
72. Vangjel Kita	0,048 %	ose 38 aksione
73. Vangjel Konini	0,088 %	ose 42 aksione
74. Vangjeli Lera	0,023 %	ose 11 aksione
75. Vangjeli Shamia	0,032 %	ose 15 aksione
76. Vasillaq Simaku	0,103 %	ose 49 aksione
77. Vjollca Meta	0,048 %	ose 23 aksione
78. Yli Polena	0,063 %	ose 30 aksione



## NENI 8 NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR, ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme e cila merr vendim me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim. Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë. Kur zmadhimi i kapitalit ndryshon të drejtat, që rrjedhin nga zotërimi i një kategorie aksionesh, vlefshmëria e vendimit të asamblesë së përgjithshme i nënshtrohet pëlqimit të aksionarëve të prekur, Miratimi, merret gjatë një mbledhjeje të posaçme, vlefshmëria e së cilës kushtëzohet nga prania e aksionarëve, të cilët zotërojnë më shumë se 1/2 e pjesës së kapitalit të shoqërisë, që përfaqësohet nga aksione me përparësi. Vendimi i posaçëm për këto çështje merret me miratimin e 3/4 të aksionarëve, që zotërojnë aksionet me përparësi, të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje. Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.

## NENI 9 NDALIMI I NËNSHKRIMIT E BLERJES SË AKSIONEVE

Shoqëria nuk mund të nënshkruajë aksionet e veta.

Një shoqëri e kontrolluar nuk mund të nënshkruajë ose të blejë aksionet e shoqërisë mëmë. Nëse gjatë procedurës së themelimit apo të rritjes së kapitalit, një i tretë, në kundërshtim nga sa më sipër, ka nënshkruar ose ka blerë aksionet për llogari të një shoqërie, apo të një shoqërie të kontrolluar, sipas pikës 2 të këtij neni, atëherë ai vlerësohet se i ka nënshkruar apo blerë ato për llogari të tij.

Aksionet e fituara, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda një viti nga data e fitimit, duhet të shiten nga shoqëria ose të anulohen dhe çregjistrohen nga regjistri i aksioneve.

Shoqëria nuk mund të ushtrojë, për aksionet e veta, të drejtat që sipas ligjit rrjedhin nga zotërimi i tyre.


## NENI 10 REGJISTRIMI DHE PUBLIKIMI I RITJES SË KAPITALIT

Administratorët detyrohen të njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Aplikimi për regjistrimin e vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me raportin e ekspertit të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë.

Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqërues duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumat e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët.

4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



Frigoriferi 2  
SH A  
Korçe Albania

## NENI 11 NDALIMI I EMETIMIT TË AKSIONEVE

Përpara se zmadhimi i kapitalit të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, aksionet e reja nuk mund të emetohen dhe të drejtat e lidhura me to nuk mund të transferohen. Aksionet e emetuara në kundërshtim me këtë dispozitë janë të pavlefshme. Personat, që kryejnë shkeljen, përgjigjen ndaj nënshkruesve në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga një emetim i pavlefshëm.

## NENI 12 ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zvogelimi i kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme e cila merr vendim me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim. Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë.

Ne mbledhjen e thirrur për këtë qëllim, dorezohet raporti i arsyetuar i Administrimit, ku shpegohen arsyet që e bejne të mundur marrjen e vendimit për zvogelimin.

Ne të gjitha rastet zvogelimi prek aksioneret në të njëjten masë, në propjestim me vlerën e aksioneve që zotërojnë.

Zvogelimi i kapitalit të shoqërisë bëhet në përputhje me nenet 181 deri në nenin 186 të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

## NENI 13 SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT

Nuk mund të merret vendim dhe të realizohet zmadhimi i kapitalit me para në dorë, nëse kapitali themeltar nuk është shlyer plotësisht. Në rast të kundërt operacioni i zmadhimit të kapitalit dhe emetimit të aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm.

## NENI 14 FORMA E AKSIONEVE

Aksionet janë nominative. Pronesia e aksioneve pasqyrohet në librin e aksioneve, të mbajtur nga ana e shoqërisë ose nga ndermjetesat financiare. Libri i aksioneve do të përmbajë në çdo kohë:

- numrin dhe kategorinë e aksioneve,
- datën e marrjes nga aksioneri,
- emrin dhe mbiemrin e aksionerit
- vlerën nominale për çdo aksion të zotëruar



Frigoriferi # 2  
SH A  
Korçe Albania

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri i aksionereve, i cili vertetohet me vulen e shoqerise.  
Secili aksioner ka te drejte te verifikojë nese emri i tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar t'i tregojë aksionerit me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.


## NENI 15 TRANSFERIMI

Aksionet jane te pandashme. Cdo aksion jep te drejten e nje vote.  
Aksionet e shoqerise jane lirisht te transferueshme ndermjet aksionereve te shoqerise.  
Aksionet e shoqerise jane lirisht te transferueshme edhe tek te tretet. Ne te dy rastet nuk eshte e nevojshme thirrja e mbledhjes se aksionereve.  
Transferimi i aksioneve si rrjedhoje e trashegimise kryhet duke respektuar legjislacionin ne fuqi.  
Ne rastet kur ndonje nga aksioneret do te transferojë nje pjese ose te gjitha aksionet e tij ndermjet aksionereve apo dhe tek te tretet, atehere ai duhet te njoftojë perfaqesuesin ligjor te shoqerise per kryerjen e veprimit perkates duke u bere shenimet perkatese ne librin e aksionereve duke i bere te njohur edhe vleren e aksioneve.

## NENI 16 AKSIONERET

Aksioneret e shoqerise jane individe dhe do te vene ne zoterim aksione te shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara nga Ligji dhe nga ky statut.  
Zoterimi i aksioneve te shoqerise u jep atyre te drejten te marrin pjese ne Asamble dhe ne votim ne perpjestim me aksionet qe zoterojne.  
Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamble e Aksionereve me kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe nga ky Statut.  
Votat qe zoterojne aksioneret jane proporcionale me perqindjet e aksioneve qe zoterojne.

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme te shoqerise ne perputhje me aksionet e tij sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin e shoqerise.  
Cdo aksioner ka te drejten te marre, kur eshte rasti, nje teprice nga likuidimi i kapitalit ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoteron.  
Aksioneret e shoqerise jane vete pergjegjes per detyrimet dhe humbjet e shoqerise, deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne.  
Pergjegjesia tej ketij kufiri eshte e ndaluar.  
Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper, ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe ai te tjetersohet tek te tretet.  
Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.



Frigoferi # 2  
SH A  
Korçe Albania

Personat e regjistruar si me sipër, prezumohen si aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota si për marrëdhëniet me shoqërinë, ashtu dhe ndaj të tretëve.

Perfaqësuesi ligjor I shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohet të lejojë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve mund të publikohet në faqen e shoqërisë në internet.

## NENI 17

### ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. **Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve**
2. **Keshilli Mbikqyres**
3. **Administratori**

### ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E AKSIONEREVE

## NENI 18

### THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme te Aksionereve thirret nga Administratoret dhe ne rastet e parashikuar ane ligj nga anetaret e keshillit mbikqyres apo dhe aksionaret e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim, nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

- a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:
  - i) të drejtat e aksionarëve, te percaktuar ne neni 139 i ligjit 9901;
  - ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;
  - iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
- c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e percaktuara ne rendin e dites;
- ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i percaktuar në rendine dites. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së pergjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:

- a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;



Frigoferi b 2  
SH A  
Korçe Albania



b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;

c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme.  
Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë se përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

## NENI 19 DREJTIMI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Mbledhjet e Asamblese se Aksionereve drejtohen nga administratori. Në mungesë të tij, këto mbledhje mund t'i drejtoje edhe një aksioner i emëruar nga Mbledhja e Aksionereve.  
Mbledhja e Asamblese se Aksionereve cakton një sekretar, i cili mund të jete ose jo aksioner.  
Aksioneret mund të përfaqesohen në Mbledhjen e Asamblese se Aksionereve, nga një aksioner tjetër apo bashkeshorti, që duhet të jene të paisur me prokurë.  
Drejtuasi i mbledhjes ka kompetence të plote të verifikojë prokurat dhe rregullsinë e tyre, arrijen e shumicës se kerkuar, me qëllim që vendimet e marra të jene të vlefshme dhe pas kesaj drejtuesi i mbledhjes vendos zhvillimin e saj.  
Gjithashtu drejtuesi i mbledhjes ka të drejte të drejtoje diskutimet dhe proceduren e votimit.  
Proces-verbalet e Mbledhjes se Asamblese nënshkruhen rregullisht nga Administratori i saj dhe sekretari.

## NENI 20 PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.  
Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.  
Procesverbalit duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.  
Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.  
Procesverbalit dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.  
Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.

## NENI 21 KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë



Frigoferi # 2  
SH A  
Korçe Albania

për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 22 të këtij statuti, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

## NENI 22 ASAMBLEJA E PERGJITHESHME

Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme të Aksionereve, mbahet të pakten një herë në vit, brenda gjashtë muajsh nga fundi I vitit financiar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare të vitit të kaluar.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të



Frigoriferi # 2  
SH A  
Korçe Albania

autorizuar.

4. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## NENI 22

### KESHILLI MBIKQYRES

#### Emerimi i anetareve të Keshillit Mbikqyres

Asambleja e Përgjithshme emeron të pakten tre ose më shumë persona fizike, gjithmone në një numer tek jo më të madh se 21 në cilësinë e anetareve të Keshillit Mbikqyres në përputhje me shkronjen "c" të nenit 22 të statutit.

Emerimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të marre me shumicë votash, i cili nëse miratohet sjell emerimin e personit të propozuar si anetar të Keshillit Mbikqyres. Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë e lidhur me shoqërinë.

Nuk mund të zgjidhen në cilësinë e anetarit të Keshillit Mbikqyres Administratorët e shoqërisë dhe të shoqërive të të njëjtit grup apo personat e lidhur me ta në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 13 të Ligjit 9901. Kufizimet e tjera për emerimin e anetareve të Keshillit Mbikqyres, parashikohen në nenin 156 të Ligjit 9901.

Shumica e anetareve të Keshillit Mbikqyres, duhet të jetë e pavarur, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit 9901.

Keshilli Mbikqyres mund të emerojë një person i cili dëshiron të ushtrojë detyrën e anetarit të Keshillit Mbikqyres për të plotësuar një vend të lirë, apo si një anetar shtesë, me kusht që të mos tejkalohet numri i anetareve të percaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Kohezgjatja në detyrë e anetareve të keshillit mbikqyres është 3 (tre) vjet.

Personat e mëposhtëm emerohen si anetare të Keshillit Mbikqyres:

1. Arben Dita
2. Jorgaq Bardhi
3. Adhurim Panariti



Frigoriferi 2  
SH A  
Korçe Albania

## NENI 23

### Kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe Komiteteve te tij

- 1) Keshilli Mbikqyres nuk merr pjese ne administrimin e shoqerise. Keshilli Mbikqyres vezhgon dhe mbikqyr zbatimin e politikave tregetare nga administratoret dhe kontrollojnë pajtueshmerite me kerkesat e Ligjit dhe te Statutit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres te percaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" te pikes 1 dhe pikes 2 te nenit 154 te Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratorit.
- 2) Keshilli Mbikqyres mund te delegoje kompetencat e tij nje komiteti qe perbehet nga nje apo me shume anetare te Keshillit Mbikqyres. Ky delegim mund te behet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosen nga Keshilli Mbikqyres e mund te revokohet ose ndryshohet. Keshilli Mbikqyres nuk mund te delegoje asnje nga detyrat te cilat i ngarkohen ne pajtim me dispozitat ligjore.
- 3) Ne perputhje me sa me siper, Keshilli Mbikqyres krijon:
  - a) Nje komitet i cili percakton standartet per emerimin e Administratoreve nga Asambleja e Pergjitheshme,
  - b) Nje komitet i cili percakton skemen e shperblimit dhe shperblimin individual te Administratoreve dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres,
  - c) Nje komitet per kontrollin e mbarevajtjes dhe kontabilitetit te shoqerise.
- 4) Komitetet e emerimit, shperblimit dhe kontrollit japin rekomandime te cilat synojne pergatitjen e vendimeve qe duhen marre nga Keshilli Mbikqyres. Qellimi kryesor i komiteteve eshte rritja e efikasitetit te Keshillit Mbikqyres duke u kujdesur qe vendimet te merren ne menyren e duhur, si dhe te ndihmojne organizimin e punes me synim sigurimin e vendimarrjes, qe nuk perben konflikt te interesave materiale. Krijimi i komiteteve nuk zhvendos ceshtjet e marra ne shqyrtim nga Keshilli Mbikqyres, i cili mbetet organi pergjegjes per vendimet e marra ne fushen e tij te kompetences.
- 5) Ne vecanti, komiteti i kontrollit financiar:
  - a) Mbikqyr procesin e raportimit financiar
  - b) Mbikqyr efektivitetin e sistemit te brendeshem dhe sistemit te administrimit te rrezeqeve
  - c) Mbikqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe te konsoliduara, sipas Statutit
  - d) Shqyrton dhe mbikqyr pavaresine e eksperteve kontabel te autorizuar , ose te shoqerise se eksperteve kontabel te autorizuar dhe ne vecanti ofrimin e sherbimeve te tjera shtese per subjektin e kontrolluar.
- 6) Bazuar ne vendimet e komiteteve te tij Keshilli Mbikqyres:
  - a) I paraqet propozime Asamblese se Pergjitheshme ne lidhje me emerimin e Administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
  - b) Harton raportin mbi ecurine e veprimtarise sipas shkronjes "e" te pikes 1 te nenit 154 te Ligjit dhe ia dorrezon ate Asamblese se Pergjitheshme, sipas pikes 3 te nenit 134 te Ligjit.
- 7) Asnje ndryshim te Statutit dhe udhezim te Asamblese se Pergjitheshme nuk mund te beje te pavlefshme veprimet e meparshme te Keshillit Mbikqyres, te cilat do te kishin qene te vlefshme, nese nuk do te ishte bere ndryshimi, apo nuk do te ishte dhene udhezimi.

## NENI 24

### Skuabifikimi dhe largimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

- 1) Detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres perfundon ne rast se:



Frigoferi N 2  
SH A  
Korçe Albania

- a) Personi pushon se qeni antar i Keshillit Mbikqyres, ne baze te dispozitave te Ligjit, duke perfshire parashikimet e pikes 4 te nenit 167 dhe nenin 157 te ligjit 9901
- b) Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese
- c) Personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore
- d) Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
- e) Ka munguar per me shume se 6-muaj rradhasi pa lejen e anetareve te tjere te Keshillit Mbikqyres ne mbledhjet e ketij keshilli te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjitheshme, me propozim te Keshillit Mbikqyres vendos ta shkarkoje ate nga detyra.

## NENI 25

### Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te mbahen te pakten 2-here ne vit, sipas nevojave te aktivitetit tregetar te shoqerise, derisa Asambleja e Pergjitheshme te vendose me shumice te thjeshte votash mbi shpeshtesine e ketyre mbledhjeve.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me kuorumin e percaktuar ne piken 5 te nenit 167 dhe nenin 162 te Ligjit. Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te marrin pjese ne mbledhje, nepermjet mjeteve elektronike te komunikimit, perfshire komunikimin video dhe audio conference. Ata mund te marrin pjese ne votime duke perdorur numtrin PIN te leshuar cdo anetari ne momentin e emerimit.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres emerojne njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejtoje cdo takim te Keshillit Mbikqyres ne te cilin ai eshte i pranishem. Ne rast se kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen, apo nuk eshte i pranishem Brenda 5-minutave nga orari i caktuar per mbledhjen, anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te emerojne njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.

Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e pjesemarrsesve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e kryetarit do te jete vendimtare.

Te gjitha aktet e kryer nga mbledhja e Keshillit Mbikqyres, ose nga komitetet e anetareve te Keshillit Mbikqyres, ose nga persona qe veprojne si anetare te Keshillit Mbikqyres, pavaresisht nese behet e ditur ne vijim se ka patur mangesi ne emerimin e nje anetari, ose keta anetare jane skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj si keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar qe te vazhdonin detyren si anetare te Keshillit Mbikqyres dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha anetaret e Keshillit Mbikqyres qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e Keshillit Mbikqyres, ose te ndonje komiteti te Keshillit Mbikqyres do te konsiderohet si I vlefshem dhe I efektshem njelloj si te ishte miratuar ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres, ose te komitetit te Keshillit Mbikqyres te mbledhur dhe zhvilluar rregullisht.

## NENI 26

### Kufizime per votimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres

Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk do te lidhin marreveshje ose te votojne ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres, ose te komitetit te Keshillit Mbikqyres per ceshtje ne te cilen keta anetare kane direkt ose indirekt nje interes apo detyrim I cili eshte material, qe eshte ne kundërshtim ose mund te jete ne kundërshtim me interes e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres te gjitha anetaret kane rene dakord qe:



Frigoriferi 2  
SH A  
Korçe Albania

Te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje dhe

Te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje

Autorizimi mund te jete I pergjithshem ose I posacem per nje ceshtje te caktuar. Zbatohet parashikimi I pikes 2 dhe 5 te nenit 13 te Ligjit.

Vota e anetarit te Keshillit Mbikqyres nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarrësve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetar nuk ka te drejte te votoje.

Ne rast se ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje anetari te ri, ceshtja mund t'i drejtohet kryetarit te mbledhjes perpara perfundimit te mbledhjes dhe vendimi I tij lidhur me cdo anetar te Keshillit Mbikqyres te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtar.

#### NENI 27

##### Procesverbalet e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres eshte pergjegjes per mbajtjen ne libra te posacem te procesverbaleve te:

- a) Te gjitha takimeve te Keshillit Mbikqyres dhe;
- b) Te gjitha mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres dhe komiteteve te tij, perfshire edhe emrat e anetareve te pranishem ne keto mbledhje.

#### NENI 28

##### SHPERBLIMI

Antaret e Keshillit Mbikqyres shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Keshilli Mbikqyres dhe te miratuar me vendim te zakonshem nga Asambleja e Pergjitheshme ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 160 te Ligjit.

#### NENI 29

##### Administratoret

##### Emerimi i administratorit

- 1) Keshilli mbikqyres zgjedh nje person fizik si Administrator te Shoqerise per nje periudhe trevjecare, ne pajtim me piken 2 te nenit 135, piken 2 te nenit 158 te Ligjit.
- 2) Keshilli mbikqyres mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratoret nga detyra, pa cenuar te drejtat qe burojne nga nje kontrate pune te lidhur me shoqerine.
- 3) Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te caktohen si Administrator. Kufizime te tjera lidhur me emerimin e Administratorit parashikohen ne piken 2 te nenit 158 te Ligjit.
- 4) Administratori i shoqerise tregtare Sh.a Frigoriferi nr 2 eshte Z. **Spito Bardhi**

#### NENI 30

##### Kompetencat e Administratoreve

##### Administratori ka per kompetence

- 1) Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise
- 2) Te perfaqesojne shoqerine tregtare
- 3) Te kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise



Frigoferi nr 2  
SH A  
Korçe Albania

- 4) Te pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecunise se veprimtarise, te cilet ia paraqesin Keshillit te Administrimit per miratim , se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, per tu paraqitur me pas per miratim nga Asambleja e Pergjitheshme
- 5) Politikat tregetare te Shoqerise do te administrohen dhe Shoqeria do te perfaqesohet nga Administratoret te cilet mund te ushtrojne te gjitha kompetencat e tyre ne perputhje me parashikimet e pikes 2 te nenit 167, shkronjave "a", "gj", "h", dhe "i" te pikes 1 te nenit 154 dhe pikave 3 dhe 5 te nenit 158 te Ligjit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 167 dhe shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" te pikes 1 te nenit 154 te Ligjit nuk mund t'iu delegohen Administratoreve.
- 6) Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Pergjithshme dhe te udhezimeve te Keshillit Mbikqyres nuk do te shfuqizojne akte te meparshme te Administratoreve, te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk dote ishte dhene.

### NENI 31

#### Skualifikimi dhe shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:


- 1) Personi nuk eshte me Administrator ne baze te dispozitave te Ligjit perfshire shkarkimin nga Keshilli Mbikqyres ne pajtim me piken 2 te nenit 167 dhe shkronjen "c" te pikes 2 te nenit 135 te Ligjit
- 2) Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese
- 3) Personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore
- 4) Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
- 5) Ka munguar per me shume se 6-muaj rradhasi pa lejen e Keshillit Mbikqyres ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe keshilli Mbikqyres vendos ta shkarkoje nga detyra.

### NENI 32

#### DETYRIMET E BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA

Pervec sa parashikohet ne nenet 14, 15, 16, 17 dhe 18 te Ligjit nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", per detyrimin e besnikerise, administratoret dhe antaret e Keshillit te Mbikqyres detyrohen:

- Te kryejne detyrat e tyre, te percaktuara ne Ligj ose Statut, ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se saj ne mjedis
- Te ushtroje kompetencat, qe i njihen ne Ligj ose ne Statut, vetem arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita
- Te vleresoje ne menyre te pershteshme ceshtjet per te cilat merret vendim
- Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, te pranishme apo te mundeshme, te interesave personale me ato te shoqerise
- Te garantoje miratimin e marreveshjeve, sipas pikes 3 te nenit 13 te ketij ligji
- Te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem



Frigoriferi 2  
SH A  
Korçe Albania

- Administratores apo antaret e Keshillit te drejtit, qe veprojne ne kundershtrim me detyrat dhe shkelin standartet e kujdesit, te permendura ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni, jane te detyruar t'I shperblejne shoqerise demet qe rrjedhin nga shkeljet
- Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, adminstratores dhe antaret e Keshillit te Administrimit jane te detyruar t'I shperblejne shoqerise demet e shkaktuara, nese ne kundershtrim me dispozitat e ketij ligji, kryejne veprimet e meposhteme:
  1. U kthejne aksionereve kontributet
  2. U paguajne aksionereve interesa apo dividente
  3. Nenshkruajne, blejne, pranojne si garanci apo anullojne aksionet e shoqerise
  4. Emetojne aksione perpara kalimit te kontributit ne natyre apo shlyerjes se vleres nominale ose me cmim me te larte
  5. Shperndajne aktivet e shoqerise
  6. Lejojne qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te ishte parashikuar qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet
  7. Kryejne pagesa ne favor te antareve te Keshillit te Administrimit apo administatoreve

### NENI 33

#### PERGJEGJESI SOLIDARE

Antaret e Keshillit te Mbikqyres dhe administratores pergjigjen ne menyre solidare per vertetesine e te gjitha pasqyrave financiare, te publikimeve te detyrueshme dhe informacioneve te tjera kryesore te veprimtarise se organizimit te shoqerise, si ato vijuese, por pa u kufizuar ne to, informacionin per sistemin e menaxhimit te riskut te shoqerise, prospektet e veprimtarise, planet e investimeve, burimet teknike etj.

### NENI 34

#### KONTROLI I SHOQERISE

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga nje ekspert kontabel i autorizuar.

Me propozim te keshillit mbikqyres, Asamblea e pergjithshme cakton nje person fizik ose nje person juridik si ekspert kontabel i autorizuar per nje periudhe 3 vjecare.

Emerimi behet me vendim te asamblese se pergjithshme me shumice te zakonshme

### NENI 35

#### LLOGARITE, VITI FINANCIAR, INVENTARI

Shoqeria mban ne zyrat e saj librat e kerkuar nga Ligji, ku mbahen llogarite vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, ne te cilat duhet te perfshihen dhe cdo kerkese tjeter ligjore.

### NENI 36

Viti financiar ka kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muaj, duke filluar nga 1-Janari e deri me 31-Dhjetor te cdo viti.



### NENI 37

#### REZERVAT E DOMOSDOSHME

Frigoriferi b 2  
SH A  
Korce Albania



Kapitali rezerve, i domosdoshem krijohet nga mbajtja e te pakten nje shume prej 1/20 te fitimeve neto te shoqerise, pasi jane zbritur me pare humbjet e mundeshme te viteve te kaluara.

Kjo procedure pushon se qeni e detyrueshme kur shuma e kapitalit te rezervuar arrin ne masen 1/10 te kapitalit te shoqerise.

#### NENI 38

#### NDARJA E FITIMEVE

Fitimet qe do te ndahen, perbejne fitimet e vitit financiar, mbasi te jene zbritur rezervat dhe humbjet e mundeshme te viteve me pare, sipas nenit te mesiperem.

#### NENI 39

#### PERCAKTIMI I DIVIDENTEVE

Mbas miratimit te bilancit vjetor dhe regjistrimn e shumes qe do te ndahet, Asambleja cakton shumen qe do te ndahet me formen e dividendeve, ne baze te kapitalit aksionar, sipas neneve te Ligjit nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"

#### NENI 40

#### PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUJDIMI

Shoqeria eshte ne likujdim e siper qe ne momentin e prishjes se saj.

Likujdimi i shoqerise behet ne baze te dispozitave te percaktuara nga nenet 187 deri 205 te Ligjit nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

Ne fazen e likujdimit, ne emertimin e shoqerise do te perfshihet edhe shprehja "ne likujdim e siper".

Ky tregues dhe emri i likujdatorit shenohen ne te gjitha veprimet dhe dokumentet qe leshohen nga shoqeria tek te tretet.


#### NENI 41

Shoqeria ka vulen e saj, ku shkruhet emri i shoqerise, sipas kerkesave ligjore.

Per ato qe nuk jane shprehur ne kete Statut, do te behet referim ne dispozitat e Ligjit ne fuqi.

Ky Statut hartohet ne 2 (dy) kopje origjinale me fuqi te njejte juridike.

#### AKSIONERET

1. Spiro Bardhi 
2. Llazi Risto,
3. Vasillaq Simaku
4. Thoma Moni
5. Abedin Mersini
6. Ylli Polena
7. Ferzilet Spaho
8. Ana Endriko
9. Mahmud Haxhillari
10. Simo Niço
11. Llazi Miti

- |                        |                          |                         |
|------------------------|--------------------------|-------------------------|
| 12. Kosta Durdi        | 31. Sotiraq   Luhonja    | 50. Armant Bendo        |
| 13. Shahin Mersini     | 32. Çlirimtar   Kotherja | 51. Lorenc    Glozheni  |
| 14. Jorgji Minga       | 33. Donika Prifti        | 52. Rozalina Lako       |
| 15. Anesti Konomi      | 34. Adrian Palo          | 53. Mihal Trajko        |
| 16. Vangjeli Lera      | 35. Arben Dellinja       | 54. Silvana    Xhemali  |
| 17. Mihal Leshi        | 36. Gjergji Leka         | 55. Piro Stefani        |
| 18. Artire Bregu       | 37. Lefteri Ceti         | 56. Vangjel Kita        |
| 19. Fitnet Mixha       | 38. Nikollaq Bino        | 57. Maksim Bilali       |
| 20. Luçi Heqimi        | 39. Mane Aliko           | 58. Stavraq Ktona       |
| 21. Vangjel Karafili   | 40. Vjollca Meta         | 59. Adrian Rapushi      |
| 22. Evas Ballauri      | 41. Ligor Qirici         | 60. Eftim Trako         |
| 23. Vangjeli    Shamia | 42. Bashkim    Jahollari | 61. Adrian Bardhi       |
| 24. Naziqe Rushiti     | 43. Gjergj Zguri         | 62. Parashqevi Zisi     |
| 25. Vangjel Konini     | 44. Nikollaq Shallo      | 63. Ibrahim    Sadikaj  |
| 26. Ilo Kita           | 45. Athina Teqo          | 64. Bujar Myrtezai      |
| 27. Lilo Kristo        | 46. Natasha    Orgocka   | 65. Fatos Çausholli     |
| 28. Pandi Balliu       | 47. Sotir Demiri         | 66. Miltjadh    Veveçka |
| 29. Pellumb Shyti      | 48. Llambi    Kolenorka  | 67. Lulezim Aliaj       |
| 30. Bashkim Ravoniku   | 49. Edmond    Shkurti    | 68. Gjergji    Trebicka |



Frigoriferi 2  
SH A  
Korçe Albania

69. Ilir Mihallari

72. Gaqi Shallo

75. Gjergji Karanxha

70. Thoma Pallonguti

73. Epaminonda Kajno

76. Reta Pano

71. Llazar Dengo

74. Anesti Kosho

77. Ilir Nikollari

78. Aleksandra Ciko

Frigoriferi № 2  
SH A  
Korçe Albania

